

AKTI I THEMELIMIT SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “CH RENT”

Unë, Dorarta Qehajaj, e bija e Shpëtimit dhe Elses, e datelindjes 06/02/1988, banuese ne **Kavaje, shtetase shqiptare** e identifikuar me **ID. I85206099N** , që në vijim do te quhet **“Ortak”**;

Unë, Sonny Qehajaj, i biri i Shpëtimit dhe Elses, i datelindjes 07/02/1999, banues ne **Itali, shtetas shqiptar** i identifikuar me **ID. J90207063K** , që në vijim do te quhet **“Ortak”**

Sot me date **06/01/2025**, vendosem te themelojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“CH RENT”** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti i shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Shitje-Blerje Automjetesh , Makina me Qira , Import-Eksport , Agjensi Turizmi.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj.

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertoje :

“CH RENT”

2.2. Selia e Shoqerise ndodhet ne : Tirane,Kavaje,Lagja nr.4, Rruga “Cezmja Sharres” ,Nd.68, H.4918 ,Ap.120, 2501

2.3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshojë regjimin juridik te Shoqerise, nese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe eksluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

4.6. Ortaku ka te drejte te beje propozime, si dhe emeroje e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likujdatoret

Neni 5

Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te papercaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte **3.000.000** (tre milion) leke I perbere nga 2(dy) kuota.

6.2. Znj. Dorarta Qehajaj ne cilesine e ortakut do te posedoje 1 kuote ,50% e kapitalit themeltar me vlere 1.500.000 leke.

6.3. Z. Sonny Qehajaj ne cilesine e ortakut do te posedoje 1 kuote ,50% e kapitalit themeltar me vlere 1.500.000 leke.

Kreu IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe ekspeti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaket e shoqerise.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1. Administrimi i shoqerise do te behet nga Administratori i saj ,Znj. Dorarta Qehajaj , titullare e kartes se identitetit me numer personal **I85206099N** .

8.2. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit.

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi I realizuar nga Shoqeria , mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakeve te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

9.2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore .Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise

ORTAKET E SHOQERISE "CH RENT" SHPK

Dorarta Qehajaj



Sonny Qehajaj

